



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1605 Prot

Tiranë, më 14/10/2019

REKOMANDIM

Nr. 45, datë 14/10/2019

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK "AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE"

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës
f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave
Personale", i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" zyra e Komisionerit për të
Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer monitorimin
on-line në faqen zyrtare <https://akep.al/programi-i-transparences/> të Autoritetit Publik
"Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare" (në vijim quajtur "Autoriteti
Publik").

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e
Informimit", kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës,
ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes
publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozitë, në përgatitjen e programit të
transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe
sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të
pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- c) modelet e miratuara për kategorinë e Autoritetit Publik nga Komisioneri për të Drejtën
e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit Publik. Nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “E drejta për informim” dhe programi i transparencës shfaqet si një nën menu.

Nga verifikimi i rubrikave të programit rezultoi se, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit, janë pasqyruar në mënyrë jo të plotë në programin e transparencës.

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj, si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo autoriteti publik.

Në lidhje me monitorimin e kryer Zyra e Komisionerit vlerëson se, problematikat e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri.

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gërmat:

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

f) informacion për shërbimet që Autoriteti Publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë.

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara në rubrika të tjera të faqes por nuk janë të ndërlidhura me tabelën e programit (të pa linkuar). Konkretisht si më poshtë:

a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

b) tekstet e plota të: i) konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) akteve nënligjore; iv) kodeve të sjelljes; v) çdo dokumenti politikash; vi) manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të Autoritetit Publik dhe që prek publikun e gjerë;

c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të Autoritetit Publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji (i pa përditësuar);

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga Autoriteti Publik.

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet ti përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në zbatim të gërmaxhe a), b), c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditore nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 14.10.2019

KOMISIONERI


Besnik Dervishi



Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/ Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – datë 10.10.2019

1. **Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare** ka publikuar programin e transparencës në faqen zyrtare në linkun <https://akep.al/programi-i-transparences/>

Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “E drejta për informim” dhe programi i transparencës shfaqet në këtë menu.



[illegible]

AKEP
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Informacioni Legjislacioni Publikime Konsultimet

Vendime të Këshillit Drejtues, Viti 2019

Vendimi Nr.33, datë 27.06.2019 – “Për miratimin e autorizimit individual të sipërmarrësit Tensikoni Albania Sh.A për përdorimin e frekuencave totale 431.411-4621 MHz (10MHz); i ciftuar me 452-462 MHz (10 MHz); të brezit 800 MHz (750-862 MHz); të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënie e të drejtave të përdorimit të brezin e frekuencave 900 MHz (790-862 MHz); spektri i paalokuar”, ref. 1X10 MHz i ciftuar 1800-2019”, zhvilluar në AKEP datë 09.09.2019”.

Vendimi Nr. 32, datë 25.06.2019 – “Për miratimin e raportit përmbledhës të KVO-së, ruajtimit e fituesit dhe botimit të fituesit, të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënie e të drejtave të përdorimit të brezin e frekuencave 900 MHz (790-862 MHz); spektri i paalokuar”, ref. 1X10 MHz i ciftuar 900-2019”.

Vendimi i Ndërmjetëm Nr.29 , datë 16.06.2019 -Për “Dhënie e afrit të vlefshëm të autorizimit individual në brezat 900 MHz dhe 1800 MHz të sipërmarrësit Albtelekom Sh.A”.

Vendimi Nr.28, datë 03.06.2019 Për “Miratimin e dokumentit të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: dhënie e të drejtave të përdorimit të brezin e frekuencave 900 mhz, spektri i paalokuar”, dhe ndërtimin për tender publik, ref. 1x10 mhz i ciftuar 900-2019”.

Publikime

- VENDIME TË KËSHILLIT DREJTUES, VITI 2009
- VENDIME TË KËSHILLIT DREJTUES, VITI 2010
- VENDIME TË KËSHILLIT DREJTUES, VITI 2011
- VENDIME TË KËSHILLIT DREJTUES, VITI 2012
- VENDIME TË KËSHILLIT DREJTUES, VITI 2013
- VENDIME TË KËSHILLIT DREJTUES, VITI 2014
- VENDIME TË KËSHILLIT DREJTUES, VITI 2015
- VENDIME TË KËSHILLIT DREJTUES, VITI 2016
- VENDIME TË KËSHILLIT DREJTUES, VITI 2017
- VENDIME TË KËSHILLIT DREJTUES, VITI 2018

7.1c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës. **Informacioni është i publikuar në menu-në “E drejta për informim”, rubrika “Kërkesë për informacion publik” por nuk është i ndërlidhur me programin.**

AKEP
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Telefoni Interneti Shërbimi Postar AKEP

Kërkesë për Informacion Publik

REPUBLIKA E SHQIPËSË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËRKESË PËR INFORMACION

Familja Mësimor:
Zotëria

Adresa postare:
Adresa elektronike:
No. Tel:

Data:
7.7.2019
Niveli i kërkesës:

Shprehja e kërkesës informacionit publik nën ndërkohë: shprehja e kërkesës informacionit të informimit


Procedura e kërkesës për informacion publik

Perdorues


- Sipërme dhe kërkesa për informim të shprehur në mënyrë të hapur
- Ankesa dhe problemet me shprehim
- Ankesa dhe problemet me shprehim
- Kërkësi ankesës
- Modifikimi i kontratës

Lajme


AKEP



7.1.d) një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime. **Informacioni gjendet i publikuar pjesërisht në menu-në “Rreth AKEP” por nuk është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës.**



7.1.dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit. **Informacioni gjendet i publikuar pjesërisht në në menunë “Operatorët” rubrikën “Publikime” (Raport Vjetore) por nuk është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës. Nuk është publikuar informacion mbi mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik.**



e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. **Informacioni nuk është i publikuar në faqe pavarësisht se citohet në tabelën e programit model të transparencës se mund të aksesohet në në faqen zyrtare në rubrikën “Publikime/Buxheti” dhe “Informacion/Pagesa”.**

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;- **Informacioni është i publikuar në faqen zyrtare menunë “Operator” rubrikën “Informacion/Pagesa/Llojet e pagesave” ndërkohë në tabelën e programit model të transparencës citohet se mund të aksesohet në faqen zyrtare në rubrikën “Publikime”.**

Llojet e Pagesave

Pagesat që kryhen në AKEP janë:

1. **Pagesa për shërbimet e tregut të komunikimeve elektronike.**
Shërbimet e tregut të komunikimeve elektronike ofrohen nga kompanitë e komunikimit, siç është: shërbimet e tregut të komunikimeve elektronike për komunikim publik dhe komunikim privat nga AKEP. Kjo pagesë mund të jetë në shumën prej 5.5 lekë të shërbimit për minutë të shërbimit të komunikimit publik dhe komunikimit privat.
2. **Pagesa për shërbimet dhe përdorimin e frekuencave.**
3. **Pagesa për shërbimet dhe përdorimin e numrave dhe të shërbimeve numerike.**
4. **Pagesa për shërbimet dhe shërbimet universale.**
Për shërbimet e komunikimit të shërbimit universal kryhen: shërbimet e komunikimit të shërbimit universal nga AKEP, siç është shërbimi i komunikimit të shërbimit universal të komunikimit publik dhe komunikimit privat dhe shërbimi i shërbimit të komunikimit të shërbimit universal të komunikimit publik dhe komunikimit privat.
5. **Pagesa për tarifat e shërbimit të radiokomunikimit.**
Tarifat e shërbimit të radiokomunikimit kryhen nga kompanitë e komunikimit të shërbimit të radiokomunikimit nga AKEP. Kjo pagesë mund të jetë në shumën prej 5.5 lekë të shërbimit për minutë të shërbimit të komunikimit publik dhe komunikimit privat.


AKEP
RREGULLORJA
STRUKTURA E AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE
MISIONI
PLANI VEPROR I PRANIMIT NË SHËRBIMIN E TREGUT TË
AKEP
KODIFIKIMI I DREJTËS E SHËRBIMIT, AKEP
REGJISTRIMI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
KËRKESË PËR INFORMACION PUBLIK
LALJI PËR VEPRIMET E INFORMIMIT

[illegible]

ANEKSI 1
Informacioni mbi formën e kërkuar për të paraqitur një mosmarrëveshje midis pajtimitarëve dhe sipërmarrësve në formë shkresore ndërmjet dorëzimit dorazi, pastaj apo në formë elektronike sipas modulit e anketa në faqen zyrtare të AKEP

Llopi i informacionit	Informacioni i kërkuar
Të dhënat e kontaktit të pajtimitarit	Emri, Adresa dhe Adresa e Postës Nr. tel E-mail
Të dhënat e kontaktit të sipërmarrësve	Supërmarrësi, Adresa Nr. tel E-mail
Përshkrimi i mosmarrëveshjes	Objekti i kërkesës për zgjidhje të mosmarrëveshjes, lloji i kontratës dhe pajtimitarëve dhe sipërmarrësve dhe mosmarrëveshjes së tyre, kushtet e përgjigjes së sipërmarrësve sipas procedurës së ankimit të dhe paraqitjes së përshkrimit dhe kushtetimitarëve të përgjigjes së sipërmarrësve lloji i ankimit.
Baza ligjore	Baza specifike ligjore e mosmarrëveshjes dhe i referencave dispozitave ligjore të marrëveshjes kontraktuale.
Kërkesat e procedurës për zgjidhje të mosmarrëveshjes	Kërkesat e procedurës nga pajtimitarët për zgjidhje të mosmarrëveshjes.
Paraqitja e dokumenteve dhe qortëve sipas urdhrave të Rregullorës	• Niveli të ankimit dhe mosmarrëveshjes; • Kopje të përgjigjes së sipërmarrësve lloji i ankimit; • Kopje të përgjigjes shkresore mbi të cilat ndërkohësisht ankimi mosmarrëveshjes (fatura tatimore, fatura e detyrës për pagime të shërbimeve të përfunduar nga sipërmarrësi); • Kopje të kontratës së pajtimitarëve lloji i ankimit.

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; - **Informacioni gjendet i publikuar pjesërisht në menunë “Operatorët” rubrika “Konsultimet” por nuk është i ndërlidhur me tabelën e programit të transparencës;**





AKEP

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

 Telefoni >
  Interneti >
  Shërbimet Postare >
  AKEP >

Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve

Nr. Kërkesës	Titulli i kërkesës	Datë e marrjes së kërkesës	Datë e përfundimit	Statusi	Shënime
1.	Si funksionon shërbimi i postës elektronike?	20.08.2018	20.08.2018	Plotësisht	1. Evidencimet kronologjike të kërkesave
2.	Si funksionon shërbimi i postës elektronike?	20.08.2018	20.08.2018	Plotësisht	2. Evidencimet kronologjike të kërkesave
3.	Si funksionon shërbimi i postës elektronike?	20.08.2018	20.08.2018	Plotësisht	3. Evidencimet kronologjike të kërkesave
4.	Si funksionon shërbimi i postës elektronike?	20.08.2018	20.08.2018	Plotësisht	4. Evidencimet kronologjike të kërkesave

Përdorues

Sqarime dhe Kërkesa për shërbime të komunikimit elektronik

Arrihet dhe Probleme me shërbimet

Arrihet dhe Probleme me shërbimet

Kërkime amatori

Mudhësi i komunikimit

Lajme



k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh – Përgjithësisht faqja zyrtare e autoritetit është e pasur me informacion, por **informacioni nuk është publikuar sipas formatit të programit model të transparencës;**

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik - **Informacioni gjendet në faqe por nuk është publikuar sipas formatit të programit model të transparencës.**

Autoriteti Publik	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Posta
Programi i transparencës	Po
Koordinatori	Po
7.1.a Përshkrim/ struktura, funksionet dhe detyrat e A.P	Po
7.1.b: Tekst, e plotë të konventa, ligje, akteve	Po
7.1.c Procedura për kërkesë për informacion	Po
7.1.ç Të dhënat e vendodhjes së AP	Po
7.d Të dhënat për arsim, pagat	Jo
7.1.dh Auditi	Po
7. 1.e Buxheti	Jo
7.ë Procedurat e Prokurimit	Po
7.1.f Shërbimet e A.P	Po
7.1.g Procedura për ankesë për veprimtarinë e AP	Po
7.1.gj Mekanizma për dhënien e mendimeve	Po
7.1.h Mbajtja e dok (Arkiva)	Jo
7.i Regjistri i kërkesave	Po (i pa përditësuar)
7.1.k Dokumente që kërkohen shpesh	Po
7.1.l Çdo Informacion i dobishëm	Po